



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-24-0211

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

J Dnga fshati C, Komuna e Deqanit,

kundër

E paditura

NSH, "APIKO"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-17-0355 të datës 14 mars 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-17-0355 i datës 14 mars 2024.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 30 qershor 2017, përmes postës paditësi, ka dorëzuar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Apiko"(në likuidim) PEJ002-0023 të datës 30 maj 2017 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, paga të papaguara dhe kompensim për kontributet pensionale në shumën totale prej 14,940.00 euro nga NSH "APIKO"(në likuidim), me arsyetimin se paditësi pas vitit 1999, nuk ishte punëtor i ndërmarrjes, dhe se atij nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të likuidimit të ndërmarrjes, andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Paditësi në ankesë pohon se në NSH "APIKO" në Deçan ka punuar në kohë të pacaktuar, dhe se ai ka të drejtë në paga të papaguara nga viti 1990 e deri në tetor 1991, po ashtu ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe kompensimin e kontributeve pensionale. Ankuesi e kundërshton konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar, dhe konstatimin se ai nuk ka qenë punëtor i NSH-së në kohën kur ka filluar procedura e likuidimit të saj. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe asnjë provë tjetër.

Me datë 01 gusht 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se paditësi nuk ishte punëtor i ndërmarrjes, dhe se atij nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të likuidimit të ndërmarrjes, andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. AKP-ja po ashtu pohoi se ishte obligim i paditësit të paraqesë prova për të mbështetur pretendimin e tij se ishte në marrëdhënie pune në NSH në kohën e likuidimit të saj. Tutje AKP-ja pohon se paditësi në ankesën e tij pjesën më të madhe të pretendimeve e ka se NSH APIKO nuk është ndërmarrje shoqërore dhe nuk bie nën administrimin e AKP-së, dhe se e njëjta nuk mund të futet në likuidim. AKP-ja pohon se bazuar në nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, AKP-ja i ka përgjegjësit ligjore për administrimin dhe përfshirjen në likuidim të ndërmarrjeve shoqërore. Tutje AKP-ja pohon se çfarëdo argumenti të

ngritur rreth administrimit apo likuidimit të ndërmarrjes nuk janë relevante për këtë procedurë. Tutje AKP-ja pohon se bazuar në deklaratat e Drejtorit të NSH-së APIKO, kjo NSH nga viti 1999, nuk ka pas aktivitet komercial, dhe si rrjedhojë paditësi nuk ishte duke punuar në kohën kur ka hyrë kjo NSH në likuidim. Prandaj likuidimi i kësaj NSH-je nuk i ka shkaktuar asnjë dëme material paditësit.

Me datë 04 mars 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-17-0355, e refuzoi ankesën e paditësit si të pa bazuar, dhe e vërtetoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ002-0023 të datës 30 maj 2017. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsytuar se çështja e parë që është dashur të zgjidhë gjykata ishte ajo se a është kërkesa e parashkruar apo jo. Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi, e që nuk janë kontestuar si të tilla as nga pala e paditur, nuk del themelësia e kërkesëpadisë. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar, për shkakun se kërkesa është e parashkruar. Pala paditëse, me kërkesën kreditore drejtuar AL-së dhe me kërkesëpadi ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara që i takojnë viteve 1990-1991. Nga ana tjetër, kërkesën kreditore për kompensim pagash e ka dorëzuar në AL me datën 26.04.2017. Gjykata potencon se sikurse legjislacioni që ishte vendosur para viteve 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite"*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se *"Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose*

në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë". Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç. Nga zbatimi i dispozitave ligjore të lartpërmendura, rezulton se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave që i takojnë viteve 1990-1991, është parashkruar me kalimin e afatit prej 3 vitesh, që nga arritja e pagave për pagesë, respektivisht në vitin 1994. Fakti se kërkesa për kompensim pagash është paraqitur në vitin 2017, tregon se paditësi ka kërkuar kompensimin e pagave, lidhur me të cilat i është parashkruar kërkesa para se ai të aplikonte pran Autoritetit të Likuidimit. Madje edhe në kohën kur Ndërmarrja ka hyrë në likuidim, kërkesa kreditore ka qenë e parashkruar. Paditësi nuk ka prezantuar ndonjë të dhënë apo informacion se ka pasur ndonjë ngjarje juridike në ndërkohë, që eventualisht do të kishte ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit. Me nenin 360.1 të LMD-së (të vitit 1978) është përcaktuar se me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Kjo dispozitë ligjore është e natyrës detyruese, prandaj detyrimi që kërkohet me kërkesën e palës paditëse nuk mund të gëzoj mbrojtje juridike, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Me datë 12 mars 2024, paditësi e dorëzoi një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-17-0355 të datës 04 mars 2024 për shkak të gjitha bazave ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Për më tepër në ankesë paditësi pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë ka dhënë konstatime të gabuara lidhur me mbështetjen e ankesës të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Ankuesi pohon se ai ishte punëtor në NSH dhe se gëzonte të drejtën e pagesës së të ardhurave personale në shumën e cekur. Në ankesë ai ka kërkuar pagesën e pagave për periudhën 1990-1991, ndërsa pohon se lidhur me çështjen e parashkrimit ai nuk ishte në dijeni, pasi nuk i ka njohur dispozitat ligjore. Tutje paditësi pohon se i tërë arsyetimi i Aktgjyimit të ankimuar mbështetet në vendimin e AKP-së, andaj mendoj se me këtë Aktgjykim është shkelur neni 182 i LPK-së. Tutje paditësi pohon se ky Aktgjykim është

kontradiktor dhe i pa arsyetuar, dhe është në kundërshtim me përmbajtjen e dokumenteve të dorëzuara.

Me datë 13 maj 2024, AKP-ja e dorëzoi një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se mbetet në pohimet dhe argumentet e paraqitura në mbrojtjen në ankesë, andaj nuk do ti përsëritë ato nga se kjo do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij e konteston vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PEJ002-0023 i datës 30 maj 2017, me të cilin kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, për kompensimin e pagave nga viti 1990-1991 dhe kompensimin e kontributeve pensionale, të gjitha në shumë prej 14,940.00 euro, ishte refuzuar si e pa vlefshme. Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar kishte nxjerrë konstatimin se paditësi pas vitit 1999, nuk ishte punëtor i ndërmarrjes, dhe se atij nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të likuidimit të

ndërmarrjes, andaj nuk i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Paditësi në ankesën e tij pretendon se ai në NSH "APIKO" në Deqan ka punuar, ndërsa nuk i janë paguar pagat nga viti 1990-1991, dhe as kontributet pensionale, dhe se ka të drejtë edhe në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në bazë të nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Paditësi me ankesën në shkallën e I-rë ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe asnjë provë tjetër.

Në procedurën ankimore paditësi vazhdon ti ketë të njëjtat pretendime, por që përsëri ai nuk i mbështet pretendimet e tij me ndonjë provë për të dëshmuar se ai i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, për t'ia njohur të drejtën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe as dëshmi se e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës për paga për periudhën e kërkuar 1990-1991. Andaj është i drejtë konstatimi i Autoritetit të Likuidimit dhe i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se paditësi nuk ka dorëzuar prova për ta mbështetur kërkesën e tij lidhur me pagat e kërkuara dhe lidhur me kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo pretendimet për shkelje të dispozitave procedurale dhe atyre materiale, pasi që janë pretendimet të pa faktuara, të përgjithshme dhe të pa argumentuara, andaj janë pretendime të pa bazuara. Prandaj nga këto arsye ankesa e paditësit, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 30 euro, me datë 22 mars 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
